



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

**Gramoz RUÇI**

**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN  
E SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2019**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke vlerësuar rolin e Komisionerit në drejtim të përmbushjes së misionit të vet parësor për garantimin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, me qëllim që ky proces të jetë i ndershëm, objektiv, i paanshëm dhe transparent;

Duke njohur përpjekjet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil drejt krijimit të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike;

Duke marrë në konsideratë gatishmërinë e Komisionerit për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet që kanë detyrë për të realizuar reformën në administratën publike, si një nga prioritetet më të rëndësishme që duhen përmbushur për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian;

**Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për vitin 2019 në drejtim të:**

Mbështetjes së dhënë njësive përgjegjëse në njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet këshillimit dhe ofrimit të asistencës teknike për vendosjen e standardeve dhe krijimit të strukturave organizative të qëndrueshme dhe efikase në përputhje me skemën e administrimit të shërbimit civil.

Mbikëqyrjes dhe monitorimit të veprimtarisë së nëpunësve civilë gjatë procesit të zgjedhjeve vendore me fokus emërimet, masat disiplinore dhe monitorimin e veprimtarisë/sjelljes së nëpunësve civilë gjatë kësaj periudhe, në kuadër të së cilës është komunikuar me 208 institucione të administratës publike, ku janë të punësuar 12 758 nëpunës civilë.

Finalizimit të procesit të administrimit të të dhënave për nëpunësit gjyqfitues për 601 vendime gjyqësore të formës së prerë të detyrueshme për t'u ekzekutuar në 208 institucione të administratës publike.

Intensifikimit të bashkëpunimit me institucionet e administratës vendore, institucionet e pavarura dhe Departamentin e Administratës Publike nëpërmjet organizimit të seancave dëgjimore me qëllim zbatimin e vendimeve të paekzekutuara për nëpunës civilë gjyqfitues, të cilët janë regjistruar në listëpritje për t'u sistemuar në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.

Mbikëqyrjes së procesit të rekrutimit, të realizuar nga Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet monitorimit të 313 procedurave të konkurrimit të realizuara në vitin 2019 për rekrutimet në grup, të lëvizjeve paralele, të ngritjeve në detyrë, si dhe të procedurave të pranimit në TND.

Finalizimit të procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme dhe tematike në 61 njësitë e vetëqeverisjes vendore të vendit, duke konstatuar problematikat e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në këto subjekte.

Mbikëqyrjes, administrimit dhe përpunimit të të dhënave për rastet e tejkalimit të afatit ligjor për lirim nga shërbimi civil për shkak të plotësimit të moshës për të dalë në pension të plotë pleqërie nga 114 institucione dhe dhënia e vendimeve për 149 raste të evidentuara.

Fillimit të hetimeve administrative nga ankesat individuale dhe informacionet e ardhura nga palët e treta, si një element me rëndësi të veçantë në krijimin e besueshmërisë në raport me institucionin dhe me qëllim rritjen e shpejtësisë së reagimit ndaj marrjes së masave për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë së pretenduar nga nëpunësit civilë.

### **Kuvendi kërkon që Komisioneri për vitin 2020 të angazhohet në këto drejtime:**

- Të gjejë mekanizmat e duhur për të adresuar pranë Kuvendit të Shqipërisë nismën për ndryshimet ligjore në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

- Të fillojë me përparësi administrimin e të dhënave nga zbatimi i VKM-së nr. 766, datë 26.12.2018, "Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil", për vitin 2019, me qëllim vlerësimin e ndikimit të këtij akti në shërbimin civil.

- Të intensifikojë procesin e verifikimit të zbatimit të vendimeve pas përfundimit të afatit të paralajmërimit për rregullimin e ligjshmërisë për institucionet që kanë nëpunës të cilët kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare, duke rritur ndërveprimin në kohë edhe me Departamentin e Administratës Publike për të bërë të mundur mospërsëritjen e situatave të tilla.

- Të vijojë procesin e hetimit administrativ për rastet individuale të konstatuara në shkelje të ligjit për proceset e rikthimit të nëpunësve civilë gjyqfitues në detyrë, si dhe të vlerësohet mundësia e ndërtimit të një databaze të përgjithshme të rekordeve historike, që të përfshijë aktet e largimit nga shërbimi civil të gjyqfituesve.

- Të punojë për krijimin e metodologjisë për përcaktimin e afateve pjesë e dispozitivëve urdhërues të vendimeve për rivendosjen e ligjshmërisë, me qëllim reduktimin e kostove buxhetore.

- Të rrisë transparencën duke mundësuar zhvillimin e një komunikimi interaktiv me qytetarin nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, si një nga mjetet e depozitimit të ankesave/informacioneve.

- Të krijojë dhe të bëjë publik, jo më vonë se 6-muaj nga data e miratimit të kësaj rezolute, një regjistër me ankesat/informacionet e marra nga institucioni, në të cilën të evidentohet edhe statusi i tyre, duke respektuar rregullat e transparencës dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.

- Të rikonceptojë rubrikat “Vendime” dhe “Raport mbikëqyrje-inspektim”, duke mundësuar krijimin e një databaze me qëllim lehtësimin e aksesit dhe njohjes së vijueshmërisë së inspektimeve të kryera dhe vendimeve të nxjerra për këto inspektime brenda vitit 2020.

Miratuar në datën 4.6.2020